



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

KONTRIBUTI I SEKTORIT BANKAR NË EKONOMINË DHE SHOQËRINË SHQIPTARE

JANAR 2018



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

KONTRIBUTI I SEKTORIT BANKAR NË EKONOMINË DHE SHOQËRINË SHQIPTARE

Ky studim është realizuar nga Op2M, Kroaci me kërkesë të
Shoqatës Shqiptare të Bankave.
Një falenderim i veçantë për bashkëpunëtorët z. Stjepan ANIC,
z. Indrit BANKA dhe z. Vladimir DAVCEV



Shoqata Shqiptare e Bankave falënderon bankat anëtare
për bashkëpunimin në kontributin e dhënë
në sigurimin e të dhënave.

Grafika: FCB Afirma

Printimi: **Gent Grafik**

Përkthimi: **We Translate Albania**

Copyright © Shoqata Shqiptare e Bankave, 2018

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij libri nuk mund të riprodhohet ose të transmetohet, në asnjë formë ose me çdo mjet elektronik, fotokopjimi ose ndryshe, pa lejen paraprake me shkrim të Shoqatës Shqiptare të Bankave.

Struktura e studimit

<i>Përmbledhje ekzekutive</i>	7
<i>Hyrje</i>	8
1. Kontributi i sektorit bankar në ekonomi	9
<i>1.1 Sektori bankar dhe rritja ekonomike në Shqipëri</i>	10
1.1.1 Kontributet e sektorit bankar në arritjen e PBB-së në Shqipëri	11
1.1.2 Prirja në rritje e sektorit bankar	11
1.1.3 Bankat si burimi kryesor dhe pothuajse i vetëm i kapitalit për ekonominë, duke u krahasuar me vendet e tjera në rajon	13
<i>1.2 Të kuptojmë rëndësinë e bankave në financat publike</i>	14
1.2.1 Roli i bankave në financimin e vazhdueshëm të buxhetit të shtetit dhe qeverisjes lokale	14
1.2.2 Mbështetja e bankave për shtetin gjatë krizës financiare	15
1.2.3 Kontributi i bankave për një funksionim efikas të thesarit të shtetit	16
1.2.4 Kontributi i industrisë bankare në buxhet përmes taksave të paguara	17
<i>1.3 Dimensionet ekonomike të zhvillimit financiar</i>	18
1.3.1 Përgjegjësia e sektorit bankar për të menaxhuar rreziqet e kredive dhe përgjegjësia për rigjallërimin e likuiditetit të ekonomisë	
<i>1.3.2 Mbështetja e veprimtarive ekonomike të:</i>	
(i) segmentit të NVM-ve, dhe (ii) individëve. Sa është vlera e huave të dhëna nga industria bankare për periudhën?	18
1.3.3 Depozitat në sektorin bankar (afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë)	19
1.3.4 Prirjet e zhvillimit të industrisë bankare gjatë periudhës, duke përfshirë produktet e reja të bankave gjatë vitit 2009- 2016	20
1.3.5 Investimet bankare në teknologji	20
2. Bankat dhe Shoqëria	22
<i>2.1 Ndërmjetësimi financiar si një e mirë publike</i>	22
2.1.1 Kontributi për kalimin nga ekonomia cash në ekonominë jo-cash	22
2.1.2 Depozitat dhe kreditë	23

2.1.3 Bankat mbështesin qytetarët në blerjen e pasurive të paluajtshme, menaxhimi me përgjegjësi i rrezikut	23
2.1.4 Roli në zhvillimin e kanaleve alternative dhe në modernizimin e kërkesës së konsumatorëve	24
2.1.5 Pagesat dhe shërbimet e tjera ofrojnë efikasitet për shoqërinë në veprimtarinë e saj të përditshme	25
2.2 Punësimi dhe Përgjegjësia Sociale	25
2.2.1 Punësimi në sektorin bankar	25
2.2.2 Donacionet dhe sponsorizimet e bankave sipas politikës së Përgjegjësisë Sociale të Korporatës	26
2.2.3 Bankat dhe edukimi financiar	27
3. Perspektivat e zhvillimit dhe bankingu në një kontekst rajonal në optikën e sektorit financiar	27
3.1 Perspektiva rregullatore dhe zhvillimi i ardhshëm i modeleve të biznesit të bankave	28
3.2 Ndërveprimi i zhvillimit të subjekteve të sektorit financiar siç janë fondet e investimeve, konceptet të tjera të këmbimit në treg dhe tregu i sigurimeve	30
3.3 Perspektiva ekonomike e Evropës Juglindore dhe ndikimi i saj	30
4. Përfundime mbi ndikimin ekonomik dhe social	32
4.1 Supozimet kryesore mbi ndikimin ekonomik dhe social të sektorit bankar modern dhe krahasimi me gjendjen aktuale në Shqipëri	32
4.2 Përfundime mbi ndikimet kryesore dhe rolin e sektorit bankar në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare	32

Përmbledhje ekzekutive

Sektori bankar në Shqipëri është kthyer në një aktor gjithnjë e më të rëndësishëm për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqenien sociale në ekonominë e vendit. Provat bindëse ofrojnë argumente të mjaftueshme në mbështetje të këtij konkluzioni të arritur, i cili njihet gjerësisht nga aktorët institucionalë vendas dhe ndërkombëtarë, po ashtu edhe nga vetë qytetarët dhe konsumatorët.

Me një vlerë të shtuar prej 3.1% të PBB-së nga sektori financiar dhe një vëllim i financimit për agjentët ekonomikë që llogaritet në vlerën 40.5 % të prodhimit të përgjithshëm ekonomik të vendit, bankat mund të konsiderohen tashmë sistemike në aspektin makroekonomik dhe si një motor rritjeje për ekonominë. Huaja e përgjithshme ndaj sektorit privat dhe individëve është rritur 8.8 herë nga viti 2004 në 2016-ën, ndërsa mjetet (asetet) e bankave kanë arritur vlerën sa 95 % e PBB-së. Kontributi i sektorit bankar në buxhetin e shtetit për vitin 2016 shënoi vlerën 6.7 miliardë lekë, në një kohë kur sektori bankar shqiptar konsiderohet fitimprurës, i mirë-kapitalizuar dhe likuid, duke garantuar financim të vazhdueshëm për veprimtaritë ekonomike. I konsideruar si një nga punëdhënësit më të rëndësishëm për sa i përket kushteve të punës, mundësive të zhvillimit të karrierës dhe sigurimit të një baze solide për përfitimet sociale të punonjësve, sektori bankar në Shqipëri konsiderohet më shumë se kurrë ndonjëherë si një forcë e domosdoshme lëvizëse që qëndron prapa rritjes cilësore harmonike të ekonomisë dhe shoqërisë.

Hyrje

Bankat janë motori lëvizës i zhvillimit financiar dhe këto institucione financiare ndërmjetësuese janë një instrument në zbutjen e fërkimeve ndërmjet agjentëve ekonomikë dhe shpërndarjes optimale të burimeve në ekonomi. Në përputhje me strukturën e përgjithshme ekonomike, bankat shërbejnë për të hapur rrugën drejt një rritjeje të qëndrueshme.

Nëpërmjet këtij studimi analitik të kërkuar nga Shoqata Shqiptare e Bankave, ekipi i ekspertëve të Op2M ka diagnostikuar kontributin më të fundit të bankave në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare për periudhën 2004 - 2016, duke mbledhur dhe shfrytëzuar të gjitha të dhënat që ndodhen në dispozicion dhe duke synuar hartimin e parashikimeve mbi potencialin e zhvillimit financiar - sinergjia e rritjes ekonomike në të ardhmen.

Qasja metodologjike e përdorur për hartimin e këtij studimi është në përputhje të plotë me objektivin kryesor të hulumtimit, për të kuptuar ndikimin dhe zgjerimin pozitiv të sektorit bankar në shoqërinë dhe në ekonominë shqiptare. Kontributi i bankave në ekonomi vlerësohet nga pikëpamja e rolit të bankave në financimin e aktiviteteve prodhuese që garantojnë mbështetje për rritjen ekonomike të vendit. Ndërkohë, kontributi në shoqëri vlerësohet duke matur ndikimin social të aktivitetit të bankave në përputhje me agjendën e Përgjegjësisë Sociale të Korporatave dhe rolin e tyre strukturor për kontributin e dhënë në financat publike.

Ky studim nis me analizën e funksionit dhe rëndësisë së bankave në mbështetje të rritjes ekonomike dhe zhvillimit social të Shqipërisë, e ndjekur me analizën e perspektivave të zhvillimit të sektorit bankar në një kontekst rajonal dhe në optikën e kontributit aktual të industrisë financiare. Përfundimet mbi ndikimin pozitiv ekonomik dhe social të bankave do të bazohen në supozimet kryesore që lidhen me sektorin bankar modern dhe krahasimin me gjendjen aktuale në Shqipëri. Komentet përfundimtare do të trajtohen në kuadër të aspekteve kryesore të rolit të sektorit bankar në ekonominë e vendit.

1. Kontributi i sektorit bankar në ekonomi

Rëndësia ekonomike e bankave në një shoqëri fillon me rolin e tyre strukturor të grumbullimit të kursimeve dhe ndarjes së burimeve në ekonomi, në drejtim të agjentëve ekonomikë financiarisht të besueshëm. Normat e interesit të aplikuara nga institucionet financiare pasqyrojnë nivelin e konkurrueshmërisë dhe plotësisë së tregjeve financiare. Për më tepër, bankat i ofrojnë sektorit privat ekspertizë të kualifikuar, duke bërë të mundur që ndërmjetësit financiarë të kontribuojnë në uljen e rreziqeve në ekonomi.

Menaxhimi optimal operacional gëzon një mbështetje cilësore nga industria e shërbimeve financiare që synon vazhdimisht produktivitet më të lartë.

Bankat shërbejnë si aktorë kryesorë në formalizimin e ekonomisë dhe rritjen e ndikimit pozitiv, duke ushtruar rolin e tyre si agjentë fiskalë, një rol kryesor për kontributin e dhënë në reduktimin e fenomenit të evazionit fiskal. Bankat ndihmojnë në reduktimin e kostove të transaksioneve për ekonominë dhe krijimin e një mjedisi më të përshtatshëm për zhvillimin afatgjatë të biznesit. Kur është fjala për nevojat e konsumatorëve, produktet bankare janë mjaft fitimprurëse për individët, duke filluar me marrjen dhe kryerjen e pagesave kudo në botë, asistencën e ofruar për shpërndarjen optimale të fondeve personale, mbrojtjen dhe kursimin e parave, si edhe menaxhimin dhe kontrollin e tyre me saktësi. Sektori bankar ndihmon qytetarët të rrisin kursimet e tyre përmes opsioneve të investimit dhe depozitave me afat. “Paqe mendore” është termi më i përshtatshëm gjithëpërfshirës për të ilustruar rëndësinë e bankave, një term që të gjithë qytetarët e përqafojnë përgjithësisht pa asnjë hezitim.

Marrëdhëniet mes zhvillimit të sektorit financiar dhe rritjes ekonomike kanë qenë gjithmonë në qendër të analizave kërkimore teorike dhe empirike të ekonomistëve, në formën e përpjekjeve kontribuuese për të kuptuar më mirë dhe për të shfrytëzuar në mënyrë më efektive efektet dhe mekanizmat e kombinuar të këtij fenomeni ekonomik në favor të zhvillimit. Procesi i zhvillimit financiar në vetvete ka evoluar në kohë si rezultat i tregjeve financiare më efikase dhe produktive dhe ndikimit të tyre gjithnjë e në rritje në zhvillimin e vendit.

Investigimi i lidhjes mes zhvillimit financiar dhe rritjes ekonomike në ekonomitë e Evropës Juglindore tregon se huatë e dhëna për sektorin privat konsiderohen mjaft pozitive për rritjen. Në fakt, deduksionet e hershme teorike theksojnë se zhvillimi i ndërmjetësve financiarë në mbështetje të nismave sipërmarrëse ndikon pozitivisht në rritjen ekonomike, duke kanalizuar burimet e financimit drejt ideve novatore më efikase në treg, të destinuara për të pasur sukses dhe, rrjedhimisht, për t'i dhënë shtysë rritjes së ekonomisë. Huat e ofruara nga këta ndërmjetës konsiderohen me rëndësi thelbësore për financimin e proceseve produktive efikase që, në fund të fundit, gjenerojnë një rendiment të lartë në pozicionin financiar të shoqërive tregtare. Shpikjet që vlerësohen të realizueshme në aspektin e prodhimit konsiderohen si mbështetje pozitive për rritjen efikase të sipërmarrjeve të prodhimit.

Por, me kalimin e viteve, është diskutuar nëse fokusi do të përqendrohej në përmirësimin e modelit neoklasik të rritjes, atëherë do të kishte një mbivlerësim të rolit të ndërmjetësve financiarë. Megjithatë, shumë pajtohen me faktin se rritja ekonomike krijon stimujt e nevojshëm për “super strukturën financiare”, me qëllim rritjen në maksimum të fitimeve dhe konsolidimin e mëtejshëm, dhe, ndërkohë, zhvillimi financiar hap rrugën për rritje të mëtejshme. Zhvillimi ekonomik përshkruhet si një produkt i përbashkët i gjeneruar mes zgjerimit të ndërmjetësve financiarë dhe rritjes ekonomike pozitive, e shoqëruar me ngushtimin e

pabarazisë në të ardhura, ndërkohë që ekonomia arrin “fazën e maturimit”. Kontributi i tyre konsiston në prezantimin e një sistemi rregullash ku ndërmjetësimi financiar dhe rritja ekonomike përkufizohen si endogjene dhe theksojnë rëndësinë vendimtare të bankave, shoqërive të sigurimeve dhe ndërmjetësve të tjerë financiarë, duke ju ofruar agjentëve ekonomikë ekspertizën e tyre, për të analizuar siç duhet informacionin e tregut në mënyrë që të optimizojë shpërndarjen e fondeve të orientuar drejt kthimeve më të larta dhe, njëkohësisht, duke minimizuar rreziqet. Zhvillimi i ndërmjetësve financiarë konkurrues (bankat) ndikon në shpërndarjen optimale të burimeve në ekonomi, të cilët kanë një ndikim pozitiv në rritjen reale të normave të rritjes ekonomike. Në këndvështrimin e akademikëve, kjo është një qasje interesante me argumentin teorik se zhvillimi konkurrues i bankave ka një ndikim pozitiv në rritjen ekonomike përmes efekteve të “ndikimeve të jashtme” që rrjedhin nga rritja e normave të kthimit nga investimet në kapital, duke rritur rrjedhimisht produktivitetin, duke pasur parasysh se ndërmjetësit financiarë konkurrues, si për shembull bankat me depozitat e parasë, kanë prirje që t’i shpërndajnë këto burime në mundësitë më fitimprurëse të investimeve, duke favorizuar kështu krijimin e një mjedisi të përshtatshëm në mbështetje të normave rritëse të kthimit nga kapitali. Por, nga ana tjetër, ngutja e agjentëve ekonomikë drejt normave më të larta shkakton reduktimin e kursimeve në ekonomi, një akumulim më të ulët të burimeve tek ndërmjetësit dhe, si rezultat, një rënie të mundshme të fuqisë financuese të bankave për depozitat e parave, duke shkaktuar një ngadalësim të ritmit të rritjes, nëse ky fenomen do të vazhdonte për një periudhë më të gjatë kohe. Përkundër faktit që, zakonisht, në literaturë konsiderohet si një marrëdhënie pozitive mes financave dhe zhvillimit, një pjesë e vëmendjes së studiuesve duhet t’i kushtohet rasteve kur zhvillimi financiar ndikon negativisht në normën e kursimeve, edhe si rrjedhojë e burimeve më të ulëta që kategorizohen në bazë të ngadalësimit të zhvillimit të ndërmjetësuesve. Përveç kësaj, ende mbeten të paqarta arsyt pse në disa ekonomi rritja e shpejtë e zhvillimit financiar shoqërohet me norma monotone standarde të rritjes ekonomike. Në përfundim, për të kuptuar më mirë produktin specifik të rritjes së tregut financiar, duhet të përqendrohemi kryesisht në tregje specifike të interesit, duke pasur parasysh faktin se ekonomi të ndryshme shfaqin karakteristika të ndryshme, duke kushtëzuar kështu marrëdhënien në fokus të këtij studimi.¹


1.1 Sektori bankar dhe rritja ekonomike në Shqipëri

- Në Shqipëri operojnë 16 banka, të cilat kanë 498 degë të shpërndara në mënyrë të përshtatshme në të gjithë vendin.
- Sektori bankar ka të punësuar 6 950 punonjës.
- Vëllimi gjithsej i asetëve (mjeteve) në sektorin bankar shqiptar, në fund të vitit 2016, arriti vlerën prej 1.407.286 mln lekë.
- Bankat janë burimi kryesor i financimit për ekonominë në përgjithësi dhe deri në fund të vitit 2016, huadhënia e përgjithshme për ekonominë nga bankat shënoi një nivel të konsiderueshëm prej 40.5% të prodhimit të brendshëm bruto.
- Ndërkohë që bankat shërbejnë si strehë parësore e sigurt për agjentët ekonomikë në ekonomi, depozitat gjithsej deri në vitin 2016 shënuan vlerën 745.526 mln lekë.
- Vëllimi i tepricës së kryegjësë së huave për ekonominë në fund të periudhës së studimit shënoi vlerën 600.367 mln lekë.
- Në vitin 2016, sektori bankar në Shqipëri shënoi një nivel pozitiv fitimi pas zbritjes së taksave, në vlerën 9.270 mln lekë.

¹ Bagehot (1873), Schumpeter (1912), Robinson (1952) Lucas (1988) Rama (2015) Greenwood dhe Jovanovic (1990), Bencivenga dhe Smith (1991)

1.1.1 Kontributi i sektorit bankar në arritjen e PBB-së në Shqipëri

Grafiku 1. Kontributi i sektorit financiar në PBB-në e vendit



Burimi: Instituti i Statistikave


Sektori bankar qëndron në epiqendër të institucioneve financiare ndërmjetësuese në Shqipëri. Kjo ndodh në sajë të faktit se, kur flasim për kontributin e sektorit financiar në produktin e përgjithshëm bruto të vendit, së pari, nënkuptojmë rolin e sektorit bankar në mbështetje të veprimtarive të ekonomisë.

Për rrjedhojë, kontributi i sektorit financiar në PBB pësoi rënie pas krizës së borxheve sovraane në Greqi dhe në Itali, dy partnerë kryesorë ekonomikë dhe tregtarë të Shqipërisë, si dhe me praninë e bankave italiane dhe greke në sistem, e cila u manifestua me vlerë të shtuar më të ulët në vitin 2012 dhe 2013. Megjithatë, nga viti 2013, vlera e shtuar e sektorit financiar në PBB u rimëkëmb dhe arriti nivelet më të larta të viteve të fundit për sa i përket vlerës së shtuar bruto.

1.1.2 Prirja në rritje e sektorit bankar

Sektori bankar ka ruajtur një prirje në rritje gjatë periudhës së studimit 2004-2016. Falë kushteve të shëndetshme financiare të sektorit bankar, kriza financiare nuk e preku rritjen e këtij sektori në mjete, të cilat arrijnë tashmë thujse nivelin e vlerës së PBB-së së vendit. Deri në vitin 2016, totali i aseteve (mjeteve) të sektorit bankar arriti vlerën 1.407.285,86 milionë lekë, ose rreth 95% të PBB-së.


Grafiku 2. Prirja e rritjes së sektorit bankar



Burimi: Banka e Shqipërisë

Sektori bankar shqiptar ka arritur të mbajë një fitueshmëri pozitive, pavarësisht krizave financiare dhe të borxhit sovran që prekën vendet fqinjë. Natyrisht që efektet negative të pasojave të krizës ekonomike u transmetuan në ekonomi, por kjo nuk ka ndikuar në shëndetin dhe stabilitetin e përgjithshëm të sektorit bankar. Megjithatë, kriza financiare ka ndikuar negativisht në fitimet e sektorit bankar në periudhën 2008-2009, duke lënë pasojë edhe në vitin 2011. Ndërkohë, ulja e nivelit të fitimeve në vitin 2016 pasqyroi një veprimtari huadhënie më të ngadaltë nga ana e bankave.

Grafiku 3. Pozicioni i fitueshmërisë së sektorit bankar në Shqipëri




Burimi: Banka e Shqipërisë

1.1.3 Bankat si burimi kryesor dhe pothuajse i vetëm i kapitalit për ekonominë, duke u krahasuar me vendet e tjera në rajon

Sektori bankar në Shqipëri ka shërbyer si burimi kryesor i huadhënies për ekonominë. Shuma e huave të dhëna nga bankat në raport me PBB-në arriti kulmin në vitin 2011, përpara krizës së borxheve sovraane të partnerëve kryesorë tregtarë të saj. Që nga ajo kohë, huadhënia ka shfaqur një prirje në rënie, por bankat dhe banka qendrore janë të angazhuara për të rritur financimin.


Grafiku 4. Shuma e huave të dhëna nga bankat për ekonominë (si % e PBB-së dhe në milion lekë)



Burimi: Banka e Shqipërisë

Ashtu siç paraqitet në grafikun e mëposhtëm, bankat në Shqipëri janë burimi kryesor dhe pothuajse i vetmi burim financimi i sektorit privat në ekonominë shqiptare. Institucionet mikro-financiare dhe unionet e kursimit-kreditimit përbëjnë rreth 2 deri në 3 për qind të totalit të kreditimit të ekonomisë për sektorin privat.


Grafiku 5: Huat e dhëna nga bankat për ekonominë



Burimi: Banka Botërore

E njëjta gjë vlen edhe nëse e shohim nga pikëpamja e një tabloje rajonale. Bankat janë ndërmjetësit kryesorë financiarë që ofrojnë mbështetje financiare për sektorin privat në Ballkanin Perëndimor. Sidoqoftë, krahasuar me vendet e tjera në rajon, mund të kuptojmë se Shqipëria ka normën më të ulët të huas ndaj sektorin privat në raport me Produktin e Brendshëm Bruto.

Grafiku 6: Kreditimi në ekonomi nga bankat në Ballkanin Perëndimor - gjashtë vende



Burimi: Banka Botërore

1.2 Të kuptojmë rëndësinë e bankave në financat publike

1.2.1 Roli i bankave në financimin e vazhdueshëm të buxhetit të shtetit dhe qeverisjes lokale


Bankat shqiptare filluan të blejnë obligacione qeveritare në vitin 2010 dhe ato ende vazhdojnë të jenë mbajtëset kryesorë të borxhit afatgjatë sovran në ekonomi, me më shumë se 75% të borxhit. Ndërkohë që vëllimi i bonove të thesarit që disponohen nga bankat ka shënuar rënie të vazhdueshme që nga viti 2004. Ky vëllim ende përbën 32,4% të totalit të bonove të thesarit të emetuara.

Por, përveç barrës së borxhit publik, bankat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbështetjen e qeverisë qendrore dhe vendore përmes financimeve, ku nivelet më të larta u shënuan në vitin 2009.

Tabela 1: Sektori bankar si mbajtës i borxhit publik shqiptar dhe kredive kundrejt qeverisë qendrore dhe vendore

	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Pjesa e bankave në bono thesari (%)	70,0	64,0	61,0	55,3	48,5	44,9	44,4	43,3	38,8	38,0	38,9	32,8	32,4
Pjesa e bankave në obligacionet qeveritare (%)							99,4	99,4	93,3	84,1	80,3	75,4	75,7
Kreditë e bankave për qeverinë qendrore dhe vendore (si % e mjeteve)	0,0	0,0	0,0	0,0	22,3	86,5	35,2	13,4	12,9	12,8	15,1	14,6	12,4

Grafiku 7: Pjesa e bankave në obligacione qeveritare dhe huat kundrejt qeverisë qendrore dhe vendore




Burimi: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave

1.2.2 Mbështetja e bankave për shtetin gjatë krizës financiare

Bankat vazhdojnë të jenë mbajtëset kryesore të borxhit në vend, duke zotëruar një pjesë të konsiderueshme të borxhit sovran që ato mbajnë, pothuajse 60% të barrës gjithsej. Gjithashtu, bankat luajnë një rol të rëndësishëm në lehtësimin e blerjes së borxhit publik nga qytetarët.

Grafiku 8: Pjesa e bankave në obligacione qeveritare dhe huat e dhëna qeverisë qendrore dhe vendore



Burimi: Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave

Pas krizës financiare të vitit 2009, sektori bankar në Shqipëri pati një bashkëpunim të ngushtë me Bankën e Shqipërisë dhe Ministrinë e Financave, për të mundësuar minimizimin e efekteve të krizës në ekonomi. Ky qëndrim bashkëpunues mbështeti menaxhimin efikas të situatës së likuiditetit të sektorit bankar, orientoi huadhënien drejt monedhës vendase, si dhe ndikoi në ruajtjen e parametrave për stabilitetin financiar dhe kapitalizimin e veprimtarisë. Me kalimin e kohës, gjëndja hyri në një fazë përmirësimi cilësor, pas rifillimit të procesit të rritjes së depozitave të publikut në sektorin bankar, i cili u zhvillua gradualisht dhe në mënyrë të qëndrueshme në tremujorin e dytë të vitit 2009 dhe vazhdoi me ritme të kënaqshme. Gjatë kësaj periudhe, bankat treguan kujdes dhe përgjegjshmëri.


Në të njëjtën mënyrë, huat e dhëna nga bankat për qeverinë qendrore dhe vendore shënuan nivelin më të lartë në vitin 2009, duke treguar se sa i rëndësishëm ishte sektori bankar në Shqipëri për të mbështetur financimin e investimeve publike dhe ndërhyrjeve qeveritare gjatë një kohe krize.

1.2.3 Kontributi i bankave për një funksionim efikas të thesarit të shtetit

Për shkak të politikës për uljen e vazhdueshme të normës së interesit, bonot e thesarit janë bërë më pak tërheqëse në aspektin e kthimit dhe, si rezultat, blerjet e këtyre titujve të borxhit nga ana e bankave kanë shënuar rënie të ndjeshme. Nga ana tjetër, bankat e kanë zhvendosur vëmendjen e tyre tek obligacionet qeveritare, duke u kthyer në mbajtësit kryesorë të borxhit në ekonomi.

Bankat e nivelit të dytë në Shqipëri luajnë një rol lehtësues, duke u dhënë qytetarëve mundësinë të investojnë kursimet dhe të ardhurat e tyre në blerjen e bonove të thesarit, duke e bërë më të lehtë që qeveria të shesë borxhin publik.

Grafiku 9: Operacionet e Thesarit



Burimi: Banka e Shqipërisë


1.2.4 Kontributet e sektorit bankar në buxhet përmes taksave të paguara dhe kontributeve të tjera dhe krahasim me sektorë të tjerë

Kontributi i sistemit financiar, në përgjithësi, dhe i bankave në mënyrë specifike për buxhetin e shtetit ka ruajtur një drejtim pozitiv, duke reflektuar në këtë mënyrë një rritje të vazhdueshme të vërtetë të sektorit bankar që erdhi si rezultat i mbështetjes që bankat u japin veprimtarive prodhuese të ekonomisë dhe njësive familjare.

Në vitin 2016, kontributi i sektorit bankar arriti në vlerën 6,76 miliardë lekë, dhe ky ishte niveli më i lartë i kontributeve për periudhën në studim.

Nëse lexojmë këto shifra, mund të kuptojmë se shoqëritë e sigurimeve dhe kontributet e fondeve të pensioneve dhe investimeve kanë shfaqur rritje të kontributeve tatimore.

Grafiku 10: Kontributi i industrisë bankare në buxhet përmes taksave të paguara



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

1.3 Dimensionet ekonomike të zhvillimit financiar

1.3.1 Përgjegjësia e sektorit bankar për të menaxhuar rreziqet e kredive dhe përgjegjësia për rigjallërimin e likuiditetit të ekonomisë

Siç u përmend më lart, në koncept, zhvillimi financiar nënvizon rëndësinë e bankave në një ekonomi si aktorë vendimtarë në menaxhimin e rreziqeve që lidhen me veprimtarinë financiare. Aktualisht, sektori bankar në Shqipëri është i mirë-kapitalizuar dhe likuiditeti i tij ka qenë vazhdimisht mbi normën rregullatore të mjaftueshmërisë së likuiditetit, në një vlerë prej 20%, duke konsoliduar kështu besimin në sektorin bankar.


Duke iu referuar raportit të Stabilitetit Financiar të Bankës së Shqipërisë², pozicioni i likuiditetit të sektorit bankar në Shqipëri qëndron në nivele të kënaqshme. Treguesit e likuiditetit si në lekë, ashtu edhe në valutë, qëndrojnë mbi nivelin minimal rregullator. Depozitat mbeten burimi kryesor i financimit, duke mbuluar pothuajse dyfishin e vëllimit të huave për këtë sektor. Sektori bankar ruan një pozicion të mirë likuiditeti, me një raport të konsiderueshëm të diskutueshëm të depozitave të klientëve kundrejt huave.

Në dhjetor 2016, raporti depozita/hua shënoi vlerën 192.8% (hua/depozita 51.9%). Sipas monedhave, ky raport shënoi 220.1% për monedhën vendase dhe 173.6% për valutën. Aktivitetet likuide në bilancet e bankave mbeten të larta, ndërsa huat rezultuan nën potencialin e tyre. Në fund të vitit 2016, aktivitetet likuide përbënin 31.3% të aktiveve të sektorit bankar, me një rënie të lehtë gjatë periudhës me 0.3 për qind.

² https://www.bankofalbania.org/web/Financial_Stability_Report_2016_H2_7752_2.php

Një tjetër tregues i likuiditetit, “aktivet likuide/gjithsej pasive afatshkurtra” pësoi gjithashtu rënie me 0.5 për qind, duke shënuar vlerën 40.6%.

Grafiku 11: Treguesit e qëndrueshmërisë financiare, në %



Burimi: Banka e Shqipërisë

1.3.2 Mbështetja e aktiviteteve ekonomike të: (i) segmentit të NVM-ve, dhe (ii) individëve. Sa është vlera e huave të dhëna nga industria bankare për periudhën (huat e paguara më parë)?

Bankat në ekonominë shqiptare u shërbejnë agjentëve ekonomikë në ofrimin e të gjitha shërbimeve financiare të disponueshme, në mbështetje të veprimtarive të tyre prodhuese. Kjo ka qenë një arsye madhore pse bankat, duke i shërbyer shoqërisë dhe ekonomisë, kanë ruajtur një ritëm të konsiderueshëm rritjeje përsa i përket aktiveve. Siç paraqitet në grafik, pas krizës bankat kanë qenë më të kujdesshme në veprimtarinë e tyre të huadhënies, dhe kjo reflektohet në prirjen e shfaqur pas vitit 2011 për huat e dhëna për sektorin privat dhe individët.

Tabela 2: Aktiviteti bankar në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve në ekonomi.


në milion lekë	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Mjete gjithsej	426440,3	496562	624279	742855	834139	886310	990631	1120168	1187983	1234321	1293721	1317843	1407286
Huat kundrejt sektorit privat dhe individëve	64824,7	118071	186572	273496	365425	410805	456820	529830	545000	531239,6	560711	551679	570622
Huat afatgjata	18712,2	33313,6	50497,2	73928	102940	113533	128660	156760	162085	159391,8	168284	165451	162080
Huat afatmesme	24560,7	38818,7	60491,6	72871,7	78720	88081,6	99882,6	116335	114453	100480,2	105816	106081	120405
Huat afatgjata	10983,4	29346,7	37312,4	63746,5	100922	110209	124003	144756	155116	159172,8	174891	172676	180850
Huat për pasuri të paluajtshme	10568,4	16532,5	38223,2	62871,2	82385	98221,9	103787	111236	113102	111569,1	111071	105661	105369
Kontratat e Leasing-ut Financiar	-	59,9	47,4	78,2	458,2	759,3	488,3	743,6	243,7	625,7	649	1810,5	1918,5
Huat për administratën publike	-	-	-	-	1857	7656,8	3554,1	1535,1	1587,9	1655,7	2031,3	1975	1781
Llogari të tjera të konsumatorëve	4974,2	8985	10292,6	17058,8	26843,8	27579,6	26115,7	30317,1	26919	30204,3	28557,6	28535,6	24461,9
Transaksionet në Tituj	29750	60395,2	91954,2	133317	166742	177727	210663	244172	256682	302410,5	327792	307608	368362

Burimi: Banka e Shqipërisë

1.3.3 Depozitat në sektorin bankar (afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë)

Ndërsa depozitat janë bërë më pak tërheqëse për publikun e gjerë për shkak se normat e interesit kanë prekur fundin, familjet vazhdojnë t'i konsiderojnë ato si një alternativë. Depozitat njëvjeçare përfaqësojnë shumicën e stokut të depozitave deri në fund të vitit 2016. Mund të vërejmë se kursimtarët shqiptarë preferojnë maturimin afatgjatë në vend të atij afatshkurtër për rezervat e tyre.

Grafiku 12: Depozitat sipas maturitetit, Dhjetor 2016



Burimi: Banka e Shqipërisë

1.3.4 Prirjet e zhvillimit të industrisë bankare gjatë periudhës, duke përfshirë produktet e reja të bankave gjatë vitit 2009-2016


Gjatë viteve të fundit, internet banking ka shënuar rritje në mozaikun e shërbimeve bankare në Shqipëri me më shumë se 223,000 transaksione në vitin 2016 dhe me një vëllim prej 1,256,879 milionë lekë me individët më shumë se sa me bizneset. Computer dhe mobile banking kanë filluar të përdoren në vitin 2014 dhe po fitojnë popullaritet të shpejtë. Kartat e kreditit kanë performuar më mirë se kartat e debitit në lidhje me numrin e transaksioneve të kryera përmes përdorimit të tyre.

Tabela 3: Numri i transaksioneve me shërbime dhe produkte të reja bankare

	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
<i>Internet banking</i>	63 422	78 156	91 274	102 070	117 233	101 092	104 532	137 803	223 110
<i>Mobile banking</i>							77,39	46	140
<i>Computer banking</i>							8 614,7	6 268	7 413
Kartat e debitit	2 014	2 566	3 151	4 719	4 740	5 739	7 914,90	9 059	11 061
Kartat e kreditit	2 182	2 756	4 287	6 195	8 657	6 772	10 006,15	11 082	13 360

Burimi: Banka e Shqipërisë

Grafiku 13: Numri i transaksioneve me shërbime dhe produkte të reja bankare




Burimi: Banka e Shqipërisë

1.3.5 Investimet bankare në teknologji

Investimet në teknologji të reja janë prioritet i bankave tregtare që operojnë në Shqipëri kur bëhet fjalë për standardet e cilësisë së shërbimeve të ofruara. Për këtë arsye, bankat kanë investuar sasi të konsiderueshme të buxheteve të tyre vjetore në përmirësimin e hardware-ve dhe software-ve. Në vitin 2016, vlera e investimeve arriti në shumën 3.3 miliardë lekë.

Për sa kohë që mund të kryhen parashikime për të ardhmen, bankat do të vazhdojnë të shërbejnë si nyje inovacioni për përshtatjen e teknologjive të reja, që do t'u mundësojnë atyre të përmirësojnë cilësinë e shërbimit që u ofrohet klientëve.

Grafiku 14: Investimi i bankave në teknologji të reja



Burimi: Shoqata Shqiptare e Bankave, 15 banka

2. Bankat dhe Shoqëria


2.1 Ndërmjetësimi financiar si një e mirë publike

Procesi që kryejnë bankat për pranimin e kursimeve nga një depozitues dhe, më pas, kreditimi ose shpërndarja e këtyre fondeve tek një huamarrës njihet si ndërmjetësim financiar. Biznesi bankar operon në modalitetin e ndërmjetësimit financiar të institucioneve financiare, në kuptimin që bankat japin hua me norma interesi relativisht më të larta, ndërsa marrin para në depozita me norma interesi relativisht më të ulëta. Në teori, ky është ndërmjetësimi financiar që në Shqipëri, ashtu si edhe në të gjitha ekonomitë në mbarë botën, konsiderohet si një funksion i domosdoshëm i institucioneve financiare në mbështetje të ekonomisë dhe agjentëve ekonomikë. Janë të shumta rastet kur ndërmjetësimi financiar konsiderohet si një e mirë publike, për shkak të rëndësisë thelbësore që ka në nxitjen e zhvillimit ekonomik dhe aktiviteteve prodhuese në ekonominë e një vendi.

2.1.1 Kontributi për kalimin nga ekonomia cash në ekonominë jo-cash

Një nga funksionet kryesore, ku sektori bankar vendas arriti të përmbushë jashtëzakonisht mirë, është zhvendosja nga një ekonomi cash në një ekonomi jo-cash, e cila është zhvilluar me një ritëm relativisht të lartë gjatë periudhës në studim. Numri i lartë i POS-ve në ekonomi në të gjithë vendin është shembulli më i mirë i kësaj lëvizjeje. Për rrjedhojë, rritja treguese e numrit të POS-ve në mbarë vendin është shembulli më i qartë i transformimit thelbësor që konsumatorët po përjetojnë kur bëhet fjalë për instrumentet e pagesave. Një tjetër element që tregon rolin në rritje të bankave në optimizimin e përdorimit të parasë cash në ekonomi është numri në rritje i ATM-ve, që pavarësisht se është shumë më i ulët në krahasim me numrin e POS-ve, ka pësuar një rritje me më shumë se tetë-fish.

Grafiku 14: Investimi i bankave në teknologji të reja




	2004	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Numri i POS-ve	155	779	1234	1832	2953	4370	4903	5126	5307	5668	6540	6689	7111
Numri i ATM-ve	93	205	309	433	642	741	771	805	823	822	811	826	800

Burimi: Banka e Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave

2.1.2 Depozitat dhe kreditë

Kriza financiare bëri që bankat të ishin më të kujdesshme në veprimtarinë e tyre të huadhënies në Shqipëri dhe kjo është e dukshme nga viti 2010 e në vazhdim, ndërkohë që kriza e borxheve u pasua nga një rritje në nivelin e depozitave dhe raporti i huave ndaj depozitave mbetet ende më i ulët se kulmi i shënuar në vitin 2009.

Grafiku 15: Huat për sektorin privat dhe individët dhe totali i depozitave në sektorin bankar shqiptar




Burimi: Banka e Shqipërisë

2.1.3 Bankat mbështesin qytetarët në blerjen e pasurive të paluajtshme, menaxhimi me përgjegjësi i riskut

Bankat kanë qenë përkrahëse për agjentët ekonomikë në financimin e blerjeve dhe investimeve të pasurive të paluajtshme. Megjithatë, nga viti 2012 e tutje, kjo prirje ka pësuar ulje. Ky rol i bankave në lehtësimin e blerjes së pasurive të paluajtshme paralelisht kontribuon në menaxhimin e rreziqeve, duke u shpërndarë burime financimi agjentëve ekonomikë të besueshëm me karakteristikat financiare të huamarrësve të mirë në terma afatgjatë.

Grafiku 16: Huat me synim pasuritë e paluajtshme në mbështetje të investimeve private




Burimi: Banka e Shqipërisë

2.1.4 Roli në zhvillimin e kanaleve alternative dhe në modernizimin e kërkesës së konsumatorëve

Viti 2014 shënoi një rritje mbresëlënëse të veprimtarisë së bankingut nga shtëpia (home banking) për sa i përket numrit të transaksioneve dhe vlerës gjithsej. Kartat e debitit janë kthyer në një mjet të domosdoshëm për konsumatorët, të cilët, gjatë dy viteve të fundit, janë përqendruar më shumë drejt bankingut nga shtëpia. E parë në një panoramë të përgjithshme, bankat në Shqipëri kanë shërbyer për të zhvilluar kanale alternative të pagesave në përgjigje të nevojave të klientëve në harmoni me prirjet moderne bankare, por edhe në përgjigje të kërkesave të klientëve shqiptarë në kërkim të standardeve më të larta të shërbimit.

Grafiku 17: Bankingu nga shtëpia, transaksionet me kartat e kreditit dhe debitit



Burimi: Banka e Shqipërisë, Shoqata Shqiptare e Bankave

2.1.5 Pagesat dhe shërbimet e tjera ofrojnë efikasitet për shoqërinë në veprimtarinë e saj të përditshme

Shërbimi i bankave ndaj shoqërisë është shumë-dimensional dhe, sigurisht, një nga çështjet kryesore është siguri i sistemit të pagesave elektronike për klientët dhe qytetarët. Pagesat elektronike luajnë një rol kryesor në rritjen e efikasitetit të ekzekutimit të pagesave; d.m.th. në kursimin e kohës dhe kostove. Studime të ndryshme empirike tregojnë se shoqëria ka rritur shpenzimet për mallra dhe shërbime vetëm për shkak të lehtësimit të ofruar nga sistemi i pagesave elektronike që ofrohen nga bankat. Në këtë mënyrë, rritet konsumi dhe rritja ekonomike, ndërsa kostot e transaksionit zvogëlohen, për shkak të konkurrencës në sektorin bankar.

Pagesat elektronike u vijnë në ndihmë familjeve dhe agjentëve të tjerë ekonomikë në mënyra të ndryshme:


- Pagesat elektronike ofrojnë qasje në burime financiare.
- Qasja në kredi ndihmon në kalibrimin e të ardhurave periodike me konsum të vazhdueshëm.
- Kartat u ofrojnë konsumatorëve instrumentet e duhura për të marrë pjesë në ekonominë digjitale.
- Meqenëse pagesat elektronike janë të sigurta, besimi në transaksionet elektronike e nxit më tej konsumin.
- Kartat e debitit dhe të kreditit ofrojnë lehtësi dhe kosto më të ulëta biznesi.
- Pagesat elektronike reduktojnë kostot e bankës qendrore në sigurimin e valutës.
- Transaksionet elektronike eliminojnë një pjesë të konsiderueshme të ekonomisë gri.

2.2 Punësimi dhe Përgjegjësia Sociale

2.2.1 Punësimi në sektorin bankar

Numri i të punësuarve në sektorin bankar ka pësuar luhatje rreth nivelit të vitit 2012, duke reflektuar një periudhë kujdesi dhe konsolidimi, ku bankat janë ndodhur gjatë viteve të fundit. Në dhjetëvjeçarin e fundit, numri i të punësuarve në sektorin bankar është dyfishuar dhe vlen të theksohet se edhe shpenzimet për trajnime dhe ngritjen e kapaciteteve nga ana e bankave për punonjësit janë rritur ndjeshëm.

Grafiku 18: Punësimi në sektorin bankar në vite



Burimi: Shoqata Shqiptare e Bankave


2.2.2 Donacionet dhe sponsorizimet e bankave sipas Politikës së Përgjegjesisë Sociale të Korporatës

Bankat në Shqipëri kanë kontribuar ndjeshëm në shoqëri, pas publikimit të Agjendës Globale 2030 të OKB-së për Zhvillimin e Qëndrueshëm.

Kontributi gjatë vitit 2016 arriti një shumë të konsiderueshme prej 4,289,800 euro, që synonte 15 nga 17 Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Më konkretisht, për secilin nga objektivat si vijon:



Donacionet dhe sponsorizimet nga bankat për shoqërinë kanë vazhduar të rriten gjatë kësaj periudhe, në bazë të analizës së ilustruar në grafikun 19 më poshtë, sipas të dhënave të marra nga Shoqata Shqiptare e Bankave.




2.2.3 Bankat dhe edukimi financiar

Mungesa e informacionit financiar mbetet një prioritet për bankat në Shqipëri dhe Shoqata Shqiptare e Bankave (AAB) luan një rol kryesor në organizimin dhe mbështetjen e fushatave të edukimit financiar.

Zgjidhjet inovative lehtësojnë qasjen në burime edukative në internet për publikun e gjerë. Falë bashkëpunimit të AAB-së me Bankën e Shqipërisë, vendi iu bashkua organizimit vjetor të Javës Globale të Parasë.

Shpenzimet për trajnime dhe edukim financiar ende mbeten të konsiderueshme, falë angazhimit të bankave në ndërtimin e kapaciteteve për edukimin financiar.

Grafiku 19: Shpenzimet nga bankat për trajnime dhe edukim financiar



Burimi: Shoqata Shqiptare e Bankave

Në vitin 2016, Shoqata Shqiptare e Bankave organizoi 23 programe trajnimi. Në këtë kuadër, ajo pati një bashkëpunim me 12 partnerë vendas dhe ndërkombëtarë, me më shumë se 346 pjesëmarrës të pranishëm në aktivitetet.

Shoqata Shqiptare e Bankave vazhdon të rritet në kuadër të misionit të saj, për t'i sjellë bankat më pranë shoqërisë dhe përsosmërisë në ofrimin e shërbimeve.

3. Perspektivat e zhvillimit dhe bankingu në një kontekst rajonal nën optikën e sektorit financiar

Sektori financiar në vendet e Ballkanit Perëndimor zotërohet kryesisht nga bankat:

- me nivele relativisht të ulëta të veprimitarisë së tregut të kapitalit;
- depërtim të papërfillshëm të produkteve të sigurimeve;
- institucione financiare jo-bankë përgjithësisht të pa konsiderueshme;

Sektori bankar ende po përballet me pasojat e krizës financiare globale që ka dobësuar cilësinë e mjeteve në sektorin financiar dhe fitueshmërinë.


Në veçanti, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM), shtylla e ekonomive të vendeve të Ballkanit Perëndimor, vazhdojnë të kenë qasje të kufizuar në hua, gjë që lidhet me nivele të larta të kostos dhe kushte kufizuese. NVM-të vuajnë nga kufizime të kapaciteteve strukturore dhe nivelet e larta të transaksioneve joformale, duke ulur cilësinë e informacionit financiar.

3.1 Perspektiva rregulatore dhe zhvillimi i ardhshëm i modeleve të biznesit të bankave

Kreditë jo-performuese (NPL) arritën kulmin në vitin 2013, kur efektet e krizës së borxhit sovran filluan të pasqyrohen në ekonominë shqiptare në një shkallë të konsiderueshme.

Falë një qasje më të kujdesshme të aktivitetit të huadhënies së bankave dhe një paketë masash të prezantuar nga Banka e Shqipërisë, raportet e NPL-së kanë pësuar rënie të mëtejshme.


Grafiku 20: NPL-të në Sektorin Bankar Shqiptar



Burimi: Banka e Shqipërisë

Pjesa më e madhe e NPL-ve në sektorin bankar shqiptar përbëhet nga hua standarde, por që nga viti 2008, huat nën-standard dhe huat e humbura kanë pësuar rritje. NPL-të bruto përfaqësojnë shumën e papaguar të huave të klasifikuara si nën standard, të dyshimta, të dyshimta për humbje dhe të humbura, ndërsa NPL-të neto përfaqësojnë shumën e papaguar të NPL-ve bruto pa provigjionet aktuale për NPL-të.

Grafiku 21: Përbërja e NPL-së



Autoritetet e sektorit financiar në të gjithë rajonin po përparojnë në drejtim të forcimit të rregullimit dhe mbikëqyrjes së sektorit bankar. Të gjitha agjencitë mbikëqyrëse në Ballkanin Perëndimor po zhvendosen drejt regjimeve mbikëqyrëse të bazuara në rrezik, si dhe në zbatimin e kërkesave të Basel II dhe Basel III. Për më tepër, të gjitha bankat kanë vënë në zbatim Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Megjithatë, disa vende ndodhen në faza të ndryshme të zbatimit të këtyre standardeve. Ka ende nevojë për përparim të mëtejshëm në zbatimin e praktikave rregullatore dhe mbikëqyrëse të bazuara në rrezik, si dhe në lidhjen e kërkesave të kapitalit rregullator me rrezikun e kredisë dhe tregut të bankave tregtare. Duhet t'i kushtohet më shumë vëmendje zbatimit të standardeve të reja, si për shembull më shumë mbikëqyrje tek bankat me rëndësi sistematike, dhe planifikim më i mirë për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen. Gjithashtu, duhet të përforcohen rregulloret në fushat e qeverisjes së korporatave, identifikimit të pronarëve përfitues fundorë dhe kreditimit të palëve të lidhura.


Sfida kryesore për rregullatorët në të gjithë Ballkanin Perëndimor është gjetja e ekuilibrit midis nevojës për një qasje të rreptë të mbikëqyrjes së bankave me nivele të larta të NPL-ve, duke nxitur ristrukturimin e borxhit për bizneset e qëndrueshme. Me rritjen e nivelin të NPL-ve dhe rritjen e dobët ekonomike, mbikëqyrësit duhet të gjejnë një qasje të ekuilibruar për të nxitur bankat për të ristrukturuar huamarrësit ende funksionalë, në mënyrë që të eliminohet NPL-ja dhe të nxitet rikapitalizimi, kur është i nevojshëm. Mbikëqyrësit duhet të zbatojnë në mënyrë më të rreptë rregullat e klasifikimit të huas, vlerësimin real të kolateralit, dhe kërkesat për provigjionimin. Zbatimi rigoroz, së bashku me zbatimin e planeve të rikapitalizimit kur është e nevojshme, do të inkurajojë bankat për të zgjidhur në mënyrë më efektive ose fshirë nga bilanci kreditë me probleme duke i kategorizuar si “write-off”. Megjithatë, deri kohët e fundit, rregullatorët në shumicën e vendeve kanë ofruar forma vetëpërmbajtje (për shembull, në provigjionim) në rast të ristrukturimit të kredive. Ky trajtim mund t'i inkurajojë bankat të mbështesin huamarrësit e qëndrueshëm, por mund të vonojë në sistemin aq të nevojshëm të bilancit me probleme të bankave, ndërkohë që në të njëjtën kohë pengon kredidhënien e huamarrësve të rinj.

3.2 Ndikimi i ndërlidhur i zhvillimit të subjekteve të sektorit financiar, siç janë fondet e investimeve, konceptet të tjera të këmbimit në treg dhe tregu i sigurimeve

Kompanitë e sigurimeve që nga viti 2013 i kanë dyfishuar primet e tyre të mbledhura. Shumica e tyre nuk kanë të bëjnë me produktin e siguracionit të jetës.

Nivelet gjithnjë e në rritje të pretendimeve të rimbursuara nga shoqëritë e sigurimeve tek klientët, përbëjnë një zhvillim pozitiv për shoqërinë. Megjithatë hendeku mes primeve të mbledhura dhe rimbursimeve është ende shumë i lartë.

Grafiku 22: Sektori i Sigurimeve në Shqipëri




Burimi: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Fondet e pensioneve gjithashtu janë përballur me një rritje të lartë të investimeve në portofol dhe të anëtarësimit. Për rrjedhojë, në vitin 2016, portofoli i investimeve të fondeve të pensione-ve arriti shumën prej 1.255 milionë lekë dhe 17 317 anëtarë, nga të cilët 9 301 anëtarë ishin gra.

3.3 Perspektiva ekonomike e Evropës Juglindore dhe ndikimi i saj

Shqipëria vazhdon të mbetet një nga ekonomitë me ecurinë më të mirë në Evropën Juglindore. Rritja ekonomike e saj parashikohet të jetë mesatarisht 4.1 % e PBB-së në katër vitet e ardhshme, një parashikim optimist krahasuar me vendet e tjera fqinje. Vlen të theksohet se bankat do të ofrojnë mbështetje për veprimtarinë prodhuese në mënyrë që të përmbushen parashikimet e rritjes.

Grafiku 23: Rritja ekonomike në Evropën Jugperëndimore në %




Burimi: Banka Botërore

Në vitin 2013, Shqipëria shënoi nivelin më të lartë të NPL-ve në rajon, duke arritur kulmin në vlerën 23.39%.

Kosova dhe Maqedonia kanë raporte më të ulëta të NPL-ve krahasuar me sektorët e tjerë bankarë në shtatë vendet e EJT-së.

Një rrugëtim i ngjashëm është vënë re në nivelet e kredive të këqija në vendet e Evropës Juglindore, duke arritur nivelet më të larta në vitin 2013 dhe duke shënuar ulje gjatë viteve pasuese.

Grafiku 24: NPL-të në shtatë vende të EJT-së



Burimi: Banka Botërore

4. Përfundime mbi ndikimin ekonomik dhe social

4.1 Supozimet kryesore mbi ndikimin ekonomik dhe social të sektorit bankar modern dhe krahasimi me gjendjen aktuale të bankave në Shqipëri

Bankat në Shqipëri e ushtrojnë veprimtarinë në sinkronizim të plotë me prirjet më të fundit në industrinë bankare. Sektori bankar modern në botën e sotme luan një rol vendimtar strukturor në grumbullimin e kursimeve dhe shpërndarjen e burimeve për agjentët më produktivë ekonomikë.

Një tjetër faktor i rëndësishëm që kontribuon ndjeshëm në ekonomi është funksioni i zbutjes së rreziqeve dhe rritja e konkurrencës së ndershme.

Bankat i ofrojnë sektorit privat ekspertizë të kualifikuar dhe këshilla të dobishme, duke nxitur një menaxhim optimal operativ në mbështetje të një produktiviteti më të lartë.

Bankat kontribuojnë në formalizimin e ekonomisë dhe luajnë rolin e agjentëve fiskalë, çka konsiderohet kryesore në kontributin për zvogëlimin e evazionit fiskal dhe kostove të transaksioneve, duke krijuar një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e biznesit.

4.2 Përfundime mbi ndikimet kryesore dhe rolin e sektorit bankar në ekonominë dhe shoqërinë shqiptare

Ndikimi ekonomik dhe social i sektorit bankar në ekonominë shqiptare ilustron më së miri nga këto dy gurë kilometrikë:

- Një vlerë e shtuar prej 3.1 për qind të PBB-së.
- Financimi për agjentët ekonomikë në nivelin 40.5 për qind të PBB-së së vendit.
- 58.2 për qind e totalit të borxhit sovran zotërohet nga 16 banka që operojnë në vend.
- Huadhënia për sektorin privat dhe individët është rritur me 8.8 herë nga viti 2004 në 2016.
- Mjetet e bankave kanë arritur 95 për qind të PBB-së.
- Kontributi gjithsej i sektorit bankar në taksa në vitin 2016 arriti kulmin në vlerën 6.7 miliardë lekë.
- Sektori bankar shqiptar është fitimprurës, i mirë-kapitalizuar dhe likuid, duke garantuar financimin e veprimtarive ekonomike.
- 6 950 punonjës janë të punësuar në sektorin bankar në nivel mbarë kombëtar.
- Bankat e kanë mbështetur inovacionin, duke investuar 3.3 miliardë lekë në teknologjitë e reja në vitin 2016.
- Vetëm gjatë vitit 2016, janë dhënë 4.530.000 euro në mbështetje të Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm për ekonominë shqiptare.
- Nga viti 2004 deri në vitin 2016, janë dhënë 1.5 miliardë lekë për sponsorizime dhe donacione për shoqërinë.

Gjatë dhjetë viteve të fundit, sektori bankar në Shqipëri është kthyer në një faktor të domosdoshëm për rritjen dhe zhvillimin e ekonomisë dhe shoqërisë së vendit.